REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA DURRËS**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 85, datë 31.08.2020

**PËR**
**VIJIMIN E PROÇEDURAVE TË PRISHJES SË DETYRUAR TË 3 PALLATEVE TË NDODHURA NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR.2, NR.3 DHE NR.4 NË ZBATIM TË EKSPERTIZAVE TË THELLUARA TË HARTUARA NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT TIRANË DHE RINDËRTIMIN E TYRE NË TË NJËJTIN TRUALL**

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", Vendimit të Këshillit Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë" i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore" si dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve, me propozim të Zëvëndëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**
**V E N D O S I :**

1. Vijimin e proçedurave të prishjes së detyruar të 3 pallateve të ndodhura në Njësitë Administrative nr.2, nr.3 dhe nr.4 në zbatim të ekspertizave të thelluara të hartuara nga Instituti i Ndërtimit Tiranë dhe rindërtimin e tyre në të njëjtin truall si më poshtë:

   - Objekt ekzistues pallat 5kt i ndodhur në Rrugën "Isuf Molla" nr.21, Lagja nr.7, Rajoni nr.2, zona kadastrale 8512, nr.pas 6/41 (Nr.GIS 23244) Durrës, prishje dhe rindërtimin në truallin ekzsitues.

- Objekt ekzistues pallat 9kt i ndodhur në Rrugën "Hysen Myshketa" nr.30, Lagja nr.6, Rajoni nr.3, zona kadastrale 8513, nr.pas 7/288 (Nr.GIS 24728) Durrës, prishje dhe rindërtimin në truallin ekzsitues.

- Objekt ekzistues pallat 5kt i ndodhur në Rrugën "Telat Noga" nr.8, Lagja nr.8, Rajoni nr.4, zona kadastrale 8511, nr.pas 3/307 (Nr.GIS 20518), përcaktuar nga Instituti i Ndërtimit në akt ekspertizë me adresë rruga "Kastrioti" nr.8 Durrës, prishje dhe rindërtimin në truallin ekzsitues.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit si dhe Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Durrës.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar).

**KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DURRËS

**U shpall sot me datë 31.08.2020**

PALLATE NE LISTE PER TU PRISHUR

| NR. | NJESIA / RAJONI | NR. KATI | ADRRESA | KODI GIS | FAZA | ZN.KADASTRALE | NR.PAS |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | RAJONI 2 | 5 KT | 21 ISUF MOLLA | 23244 | PER TU PRISHUR | 8512 | 6/41 |
| 2 | RAJONI 3 | 9 KT | 30 HYSEN MYSHKETA | 24728 | PER TU PRISHUR | 8513 | 7/288 |
| 3 | RAJONI 4 | 5 KT | 8 \| TELAT NOGA | 20518 | PER TU PRISHUR | 8511 | 3/307 |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SEKRETARIA
BASHKIA DURRËS

1

# RAJONI 3 PALLATE PER PRISHJE RRUGA HYSEN MYSHKETA NR

LISTA E PALLATEVE PER PIRSHJE NJESA ADMINISTRATIVE 3

| Nr. | NJESIA./RAJONI | NR. KATI | ADRRESA | KODI GIS | PRISHJE/RIFORCIM | | APARTAMENET | NR.FAMILJE | ZN.KADASTRALE | NR.PAS | PROT/DATE |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| R-3 | | | | | | | | | | | |
| | RAJCNI 3 | 9 KT | 30\| HYSEN MYSHKETA | 24728 | PER TU PRISHUR | | | | 8513 | 7/288 | |



(2)

## RAJONI 2 PALLAT PER FRISHJE RRUGA ISUF MOLLA NR.

| Nr. | NJESIA / RAJONI | NR. KATI | ADRRESA | KODI GIS | FAZA | | APARTAMENTE | NR.FAMILJE | ZN.KADASTRALE | NR.PAS |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **R-2** | | | | | | | | | | |
| | RAJONI 2 | 5 KT | 21 \| ISUF MOLLA | 23244 | PER TU PRISHUR | ▒ | | | 8512 | 6/41 |



## RAJONI 4 PALLATE PER FRISHJE RRUGA TELAT NOGA NR

LISTA E PALLATEVE PER PIRSHJE-NJESA ADMINISTRATIVE 4

| Nr. | NJESIA / RAJONI | NR. KATI | ADRESA | KODI GIS | PRISHJE/RIFORCIM | | ZN.KADASTRALE | NR.PAS | SIP.NJOLLA / m2 | NR.FAMILJE | AP. 3+1 | AP. 2+1 | AP. 1+1 | PROT/DATE |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **R-4** | | | | | | | | | | | | | | |
| | RAJONI 4 | 5 KT | TELAT NOKA | 20518 | PER TU PRISHUR | | 8511 | 3/307 | 319 | | | | | |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr.804/3 prot. Durrës, më 03.09.2020

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

BASHKIA DURRES
11017
Dt: 4/9/20 Nr.____PROT

**KËSHILLIT BASHKIAK**

**DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.85 datë 31.08.2020 "Për vijimin e procedurave të prishjes së detyruar të 3 pallateve të ndodhura në Njësitë Administrative Nr. 2, Nr. 3 dhe Nr. 4 në zbatim të ekspertizave të thelluara te hartuara nga Instituti i Ndërtimit Tiranë dhe rindërtimin e tyre në të njëjtin truall".

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**ROLAND NASTO**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT DURRËS